

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORATI

Nr. 2881 Prot

Durrës, më: 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 20, datë 18.12.2025

PËR

"CAKTIMIN E DATAVE 22, 23 dhe 24 DHJETOR 2025, DITË PUSHIMI PËR PROCESIN MËSIMOR NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të Kalendarit Akademik për vitin 2025-2026 miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 98, datë 18.09.2025, si dhe referuar kërkesës së Këshillit Studentor administruar me Nr. 2975 Prot., datë 18.12.2025, Rektorati,

V E N D O S I:

1. Të shpallë ditë pushimi datat 22, 23 dhe 24 Dhjetor 2025 për procesin mësimor në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Këto data të zëvendësohen deri në përfundim të semestrit të parë të vitit akademik 2025-2026;
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Shkëlqim FORTUZI

